



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 324 Prot

Datë, 04.03 2021

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTET E
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 9, 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor:
 - i. “Strategjia Territoriale” - Bashkia Durrës;
 - ii. “Plani i Zhvillimit Territorial” - Bashkia Durrës;
 - iii. “Rregullorja e Planit” - Bashkia Durrës;
2. Pjesë përbërëse e këtij Akti Përputhshmërie është:
 - “Raporti i Vlerësimit Teknik” i Dokumenteve “Strategjia Territoriale”, “Plani i Zhvillimit Territorial”, “Rregullorja e Planit” të Bashkisë Durrës.
3. Akti i Përputhshmërisë për Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës lëshohet me kusht që bashkia të risjellë në afat Deklaratën Mjedisore në zbatim të Ligjit Nr.91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”, përpara shqyrtimit dhe miratimit të dokumentit të planifikimit në Këshillin Kombëtar të Territorit.

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT